



Ne përputhje me dispozitat e nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe autorizimet që ia mundëson neni 6 i Ligjit Nr. 04/L-101 i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-168 për Fondet Pensionale të Kosovës, për pjesën që ka të bëjë me përgjegjësitë e Administratës Tatimore, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

## VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01/2013

### RREGULLAT IMPLEMENTUESE TË LIGJIT PËR FONDET PENSIONALE TË KOSOVËS

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtyre rregullave implementuese është për të sqaruar se si Administrata Tatimore e Kosovës do të interpretojë dhe zbatojë dispozitat e Ligjit Nr.04/L-101, të datës 30 mars 2012, i ndryshuar me Ligjin 04/L-168, i datës 12 mars 2013, për Fondet Pensionale të Kosovës, në fushat që lidhen me Administratën Tatimore të Kosovës.

#### Neni 2 Përkufizimet

“**Ligj**” do të nënkuptojë Ligjin Nr.04/L-101 i ndryshuar me Ligjin 04/L-168, për Fondet Pensionale të Kosovës.

“**FKPK**” do të nënkuptojë Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, që është një Institucion i pavarur i themeluar nga Ligji për qëllim të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për kursimin e pensioneve.

“**Fond Plotësues**” janë fondet e shtyllës së tretë të sistemit pensional në Kosovë, që themelohen dhe operojnë sipas ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

“**ATK**” do të nënkuptojë Administratën Tatimore të Kosovës, që sipas Ligjit mbledh Kontributet Pensionale në Kosovë dhe cakton rregullat e mbledhjes së kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale.

“**EDI**” do të nënkuptojë sistemin online për gjenerimin e formularëve të pagesës së kontributeve pensionale dhe tatimit në paga.

“**I punësuar**” është personi fizik i cili kryen punë për pagë nën drejtimin dhe kontrollin e punëdhënësit, pavarësisht se a kryhet puna sipas kontratës ose ndonjë forme tjetër të marrëveshjes qoftë e bërë me shkrim apo jo.

“**Punëdhënësi**” çdo person fizik ose juridik i cili vepron drejtpërdrejt ose tërthorazi në interes të punëdhënësit dhe përfshin një asociacion ose grup punëdhënësish që veprojnë për një punëdhënës në

atë cilësi. Punëdhënësi mund të jetë në pronësi shtetërore ose shoqërore e kontrolluar nga shteti, në, pronësi private ose mund të jetë një kombinim i pronësisë dhe i kontrollit shtetëror-shoqëror dhe privat, si dhe mund të jetë person juridik me ose pa përfitim.

“**Persona të vetëpunësuar**” personat të cilët (a) fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave (duke përfshirë

edhe mallrat teknologjike, komerciale, bujqësore, artistike, arsimore ose pronën intelektuale) apo nga

ofrimi i shërbimeve dhe (b) bëjnë shitje të tilla apo ofrojnë shërbime, të cilat nuk janë nën kontrollin apo

mbikëqyrjen e punëdhënësit dhe kështu nuk konsiderohen të punësuar.

“**Paga minimale**” siç shpallet nga Këshilli Ekonomiko-Social.

### **Neni 3 Fushëveprimi**

Të gjithë të punësuarit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit që janë shtetas të Kosovës dhe të cilët aktivitetin e tyre ekonomik e kryejnë në Kosovë, janë të obliguar të kontribuojnë në financimin e pensionit të kursimeve.

Të punësuarit në Kosovë, të cilët kanë qëndrim të përhershëm sipas Nenit 51 të Ligjit për të Huajt (Nr. 04/L-069) si dhe punëdhënësit përkatës të tyre, po ashtu obligohen të paguajnë kontribute pensionale. Të punësuarit me qëndrim të përkohshëm e kanë të ndaluar të paguajnë kontribute pensionale.

ATK është Agjencioni i ngarkuar me përmbushjen e obligimit për pagesë të kontributeve pensionale, ndaj në çdo rast ATK mban të drejtën e kontrollit dhe mbledhjes së detyrueshme.

### **Neni 4 Kontributet e obliguara**

Shkalla e obligueshme e kontributit pensional për të punësuarit është 5% nga paga mujore bruto e të punësuarit dhe 5% të tjera nga mjetet e punëdhënësit. Të dy këto pjesë destinohen për kursim të të punësuarit.

Shkalla e obligueshme e kontributit pensional për të vetëpunësuarit që deklarojnë tatim në bazë të paragjykuar (bizneset e vogla individuale) është 1/3 e obligimit tatimor të deklaruar në bazë tremujore ose €600, cilado që është më e ulët.

Shkalla e obligueshme e kontributit pensional për të vetëpunësuarit që deklarojnë tatim në të ardhura reale (bizneset e mëdha individuale) është 10% deri në 30% të të ardhurave, para zbritjes së kontributit pensional, ose 600€, cilado që është më e ulët.

Kontributet pensionale të të vetëpunësuarve për një tremujor nuk mund të jenë më të ulëta se sa 30% e pagës minimale në Kosovë.

Kontributet e obliguara mund të kenë si destinim vetëm FKPK-në.

### **Neni 5 Kontributet vullnetare**

Punëdhënësi dhe i punësuarit lejohen vullnetarisht të kontribuojnë më tepër se shkalla e obligueshme prej 5% e pagës bruto të të punësuarit. Punëdhënësi nuk është i obliguar të ndjekë shkallën e kontributit vullnetar të të punësuarit dhe anasjelltas.

Kontributet vullnetare të të vetëpunësuarve mund të jenë deri në dyqind (200) përqind të kontributit të obliguar sipas Nenit 4.

Kontributet vullnetare mund të kenë dy destinime: FKPK-në apo Fondet Plotësuese.

Kontributet vullnetare në FKPK – Shkalla maksimale e lejueshme e kontributeve vullnetare është 10% e pagës bruto nga i punësuarit dhe 10% e pagës bruto nga punëdhënësi, për të arritur së bashku me kontributet e obliguara në një maksimum prej 30% të pagës bruto (15% nga i punësuarit dhe 15% nga punëdhënësi).

### **Neni 6 Implikimet tatimore**

Baza e kalkulimit të Tatimit në të Ardhurat Personale për të punësuarit, do të konsiderohet paga bruto pas zbritjes së Kontributit Pensional (pjesës së të punësuarit). Pjesa e Kontributit Pensional e të punësuarit (deri në 15% të pagës bruto) është e zbritshme nga Tatimi në të Ardhura Personale për të punësuarin. Po ashtu, pjesa e Kontributit Pensional (deri në 15% të pagës bruto së të punësuarit) nga punëdhënësi, punëdhënësit i njihet si shpenzim për qëllim të Tatimit në të Ardhura Personale dhe/ose Tatimit në të Ardhura të Korporatave.

Për të vetëpunësuarit vetëm pjesa e obligueshme e kontributeve pensionale do të jetë e liruar nga tatimi në të ardhura personale.

### **Neni 7 Baza e llogaritjes të kontributit pensional për të punësuarit**

**Paga bruto** – është çdo kompensim i të punësuarit nga punëdhënësi për punën apo shërbimet e kryera qoftë marrëveshje me shkrim ose marrëveshje tjetër. Përveç pagës bazë, edhe shtesat/benefitet tjera siç janë të definuara me ligjin për Tatim në të Ardhura Personale, konsiderohen si pagë bruto rrjedhimisht i shtohen bazës së kalkulimit të kontributeve pensionale.

**Paga minimale** – Për punëdhënësit sekondar (dytësor) ose kur i punësuarit punon në orar të shkurtuar tek punëdhënësi primar, atëherë punëdhënësi duhet të marrë për bazë pagën bruto sipas paragrafit sipër për kalkulimin e kontributeve pensionale edhe nëse paga bruto është më e vogël se sa paga minimale. Nëse i punësuarit punon me orar të plotë tek punëdhënësi primar por kompenzohet për punën e tij/saj me të ardhura (qofshin ato në para apo natyrë) më të vogla se sa paga minimale, punëdhënësi duhet të marrë për bazë pagën minimale për kalkulimin e kontributeve pensionale.

**Pagat e paguara në natyrë** – nënkupton vlerën e hapur monetare të tregut për mallrat apo shërbimet e ofruara nga punëdhënësi për të punësuarin, në mungesë të kompenzimit me parë të gatshme, si formë e zakonshme e kompenzimit të të punësuarve. Në aneks është dhënë shembulli i kalkulimit të pagës në natyrë.

Nëse punëdhënësi paguan paga më shumë se një herë në muaj, nga ai/ajo kërkohet që kalkulimet t'i bëjë vetëm në bazë mujore. Pra, në këto raste, obligimi mujor është shuma e të gjitha obligimeve të krijuara nga pagat e paguara brenda muajit.

## **Neni 8**

### **Mbajtja në burim e kontributeve pensionale**

Secili punëdhënësi është i obliguar që në momentin e shpërndarjes/dhënies së pagës për të punësuarit të mbajë në burim Kontributin Pensional të obligueshëm të të punësuarit. Kontributi Pensional vullnetar i të punësuarit me destinim FKPK-në po ashtu duhet të ndalet në burim.

## **Neni 9**

### **Identifikimi i personave fizik**

Për qëllim të raportimit të kontributeve pensionale dhe tatimit në të ardhura personale, numri personal i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Kosovës, ose numri individual fiskal i lëshuar nga ATK, janë numrat e vetëm identifikues për çdo të punësuar. Si shtetasit e Kosovës po ashtu edhe banorët të cilët kanë fituar qëndrim të përhershëm duhet të kenë numër personal të përhershëm, të lëshuar nga MPB.

Për qëllim të raportimit të Tatimit në tëAardhura Personale, të punësuarit jo-rezidentë të Kosovës mund të identifikohen edhe me numër fiskal për individë.

Të vetëpunësuarit, identifikohen duke ofruar numrin individual fiskal dhe numrin personal në kutitë përkatëse të formularit për pagesë të Kontributeve Pensionale për të vetëpunësuarit. Partnerët e bizneseve individuale identifikohen me numrin individual fiskal (jo me numrin fiskal të subjektit) dhe numrin personal.



## **Neni 10**

### **Deklarimi i kontributeve pensionale dhe tatimit në paga të të punësuarve**

Përmes sistemit online të deklarimit (EDI), punëdhënësi duhet të ngarkojë listën mujore të pagave në format të MS Excel® duke ndjekur të gjitha udhëzimet në manualin e raportimit të Kontributeve Pensionale dhe Tatimit në Paga.

Pasi të jetë ngarkuar lista e pagave, EDI do të gjenerojë fletëpagesën, me të cilën bëhet pagesa e Kontributeve Pensionale dhe Tatimit në Paga. Meqë pagesa definohet nga lista e ngarkuar, punëdhënësi duhet të përkujdeset që të gjithë të punësuarit për të cilët paguhen kontributet duhet të përfshihen në listë dhe të jenë të identifikuar me numrat përkatës personal. Fletëpagesa nuk do të mund të gjenerohet nëse punëdhënësi ka gabime në identifikim të të punësuarve dhe në kalkulim të kontributeve pensionale me rastin e deklarimit.

## **Neni 11**

### **Korrigjimi i deklarimit**

Punëdhënësit mund të korrigjojnë deklarimin e kontributeve pensionale dhe tatimit në paga përmes sistemit online të deklarimit (EDI). Nëse njëri nga të punësuarit që figuron në deklaratën e korrigjuar (origjinale) nuk figuron në deklaratën korrigjuese ose deklarohet me më pak kontribute pensionale që kanë për destinim FKPK-në, atëherë deklarata do të konsiderohet e pezulluar dhe punëdhënësi duhet të kërkojë aprovim nga Inspektori Tatimor që deklarata korrigjuese të pranohet nga ATK. Në rastet tjera deklarata korrigjuese do të pranohet automatisht dhe nuk do të ketë nevojë për aprovim nga Inspektori Tatimor.

Procedura e përmirësimit të raporteve nga punëdhënësi është e detajuar në manualin e raportimit të kontributeve pensionale dhe tatimit në paga përmes EDI-t.

## **Neni 12**

### **Pagesa e kontributeve pensionale dhe tatimit në paga**

Pagesa e kontributeve pensionale dhe tatimit në paga për të punësuarit mund të bëhet vetëm me formularët e gjeneruar nga EDI, në të cilët janë të dhëna detajet e nevojshme të pagesës. Formulari i pagesës nuk mund të ndryshohet me dorë, të paguhet me të për periudha të tjera tatimore ose për tatimpagues të tjerë, e as të paguhet dy herë me të. Për çdo përmirësim, duhet të respektohen rregullat e deklarimit online.

Pagesa e Kontributeve Pensionale dhe tatimit në të ardhura për të vetëpunësuarit mund të bëhet vetëm duke shkarkuar deklaratë përkatëse nga faqja e internetit e ATK-së.

Formularët e pagesave duhet të shtypen në kopje. Banka mban kopjet e mjaftueshme për vete, dhe një kopje e kthen tek pala.

Pagesa e Kontributeve Pensionale aty ku është e aplikueshme mund të bëhet edhe me e-banking. Në këto raste, tatimpaguesi duhet të sigurohet se të dhënat e kërkuara nga softueri i bankës, jepen në mënyrë të saktë (numri fiskal, numri serik i formularit - uniref, periudha, shuma). Përshkrimi

i transaksionit, së paku duhet të ketë numrin serik të formularit, numrin fiskal dhe periudhën tatimore për të cilën bëhet pagesa. Për të vetëpunësuarit përshkrimi duhet të përmbajë edhe numrin personal të personit të vetëpunësuar. Poashtu, deklarata fizike e të vetëpunësuarve duhet të dërgohet në ATK për procesim.

### **Neni 13**

#### **Çertifikata e Kontributeve dhe Tatimit në Paga, të Mbajtura në Burim dhe të Paguara**

Secili punëdhënës, deri më 31 Janar të vitit vijues është i obliguar për t'i dorëzuar secilit të punësuar Çertifikatën e Kontributeve dhe Tatimit në Paga, të Mbajtura në Burim dhe të Paguara në emër të secilit të punësuar. Format i Çertifikatës është i dhënë në aneks.

### **Neni 14**

#### **Mbajtja e librit të kontributeve pensionale dhe tatimit në paga**

Për qëllim të kësaj rregulle, secili punëdhënës obligohet të mbajë informata të sakta për identitetin, pagën bruto dhe kontributet pensionale të të punësuarve të vet. Këto informata duhet të mbahen si listë mujore e pagave në formatin e dhënë në aneks, në periudhë prej 6 viteve.

Libri duhet të jetë përmbledhje mujore e detajeve të të punësuarve, ku secili rresht përmban një person, bashkë me numrin personal dhe informatat për pagën bruto dhe kontributet pensionale.

Në qoftë se, pas deklarimit fillestar, dalin obligime dhe detyrime shtesë për kontribute ose tatim në paga për një periudhë të caktuar (si akt vullnetar i punëdhënësit apo si rezultat i kontrollit nga Inspektori Tatimor), lista e re duhet të përpilohet dhe të mbahet me detajet dhe totalet e reja të listës së pagave për periudhën përkatëse. Deklarata e korigjuar patjetër duhet të dorëzohet siç është përcaktuar në Nenin 11.

### **Neni 15**

#### **Deklarimi dhe pagesa e kontributeve pensionale nga të vetëpunësuarit, partnerët dhe aksionarët e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar**

Çdo i vetëpunësuar dhe/ose partner biznesi në biznes individual, ose aksionar në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Kosovë (i cili aksionar është i angazhuar me punë në shoqërinë përkatëse aksionare), i cili është shtetas i Kosovës ose me qëndrim të përhershëm, është i obliguar të deklarojë dhe paguajë kontributin pensional nga të ardhurat personale.

Përcaktimi i pagës minimale dhe kategoritë për to do të mund të ndryshojnë përgjatë kohës.

Për qëllime të kontributeve pensionale, aksionarët e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar obligohen të hyjnë në listë të pagave nëse kanë angazhime në veprimtarinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Aksionarët që nuk kryejnë asnjë punë në shoqërinë përkatëse (Aksionarët e heshtur) nuk janë të obliguar të regjistrohen në listë të pagave (rrjedhimisht lirohen nga obligimi për tatim në pagë dhe kontribute pensionale).

Përmirësimi i deklaramit tek të vetëpunësuarit konsiston në korigjimin e informatës dhe/ose korigjimin e deklaramit dhe pagesës. Varësisht nga rasti, i vetëpunësuarit duhet të shenjojë kutinë përkatëse.

Në fund të vitit, të vetëpunësuarit (pronarë të bizneseve të mëdha individuale) me rastin e deklaramit vjetor të tatimit në të ardhura personale, kanë mundësi të bëjnë pagesë shtesë ose refondim të kontributeve pensionale si rezultat i barazimit vjetor të obligimeve.

### **Neni 16** **Participimi vullnetar në skemën e kursimeve pensionale**

Të gjithë personat fizik, të cilët janë shtetas të Kosovës dhe të cilët janë të liruar nga obligimi për tatim në të ardhura personale në Kosovës (sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë) mund të paguajnë çdo muaj kontributet pensionale nga të ardhurat e tyre të realizuara në Kosovë duke u pajisur me numër individual fiskal dhe duke zgjedhur opcionin e deklaramit vullnetar në EDI.

### **Neni 16** **Refondimi i kontributeve pensionale**

Të gjithë punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit mund të aplikojnë për refondim të kontributeve pensionale. Refondimi mund të jetë kthim i parave në kesh, ose rishpërndarje e pagesës në periudha tjera tatimore. Kërkesa për refondim duhet të bëhet përmes formularëve përkatës. Refondimi duhet të aprovohet nga Inspektori Tatimor. Formulari i aprovuar duhet të dorëzohet në FKPK për procesim.

### **Neni 17** **Hyrja në fuqi**

Ky vendim shpjegues përcakton rregullat implementuese të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Data: 12/09 2013

Prishtinë,

z. Behxhet Haliti  
  
Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës



## ANEKS

### Shembull i kalkulimit të Kontributit Pensional

Nëse një i punësuar ka pagë mujore bruto prej 500€, atëherë kalkulimi i shkallës minimale të Kontributit Pensional është  $500€ \times 5\% = 25€$  si pjesë e punëtorit dhe  $500€ \times 5\% = 25€$  si pjesë e punëdhënësit. Shpenzimi total i punëdhënësit për të punësuarin nga shembulli i përmendur është 525€.

Përshkrimi	Shuma
Paga	500.00€
Shtesa tjera*	20.00€
Gjithsejt paga bruto	520.00€
Kontributi pensional i punëdhënësit	26.00€
Kontributi pensional i të punësuarit	26.00€
Paga neto para tatimit	494.00€
Tatimi në pagë**	27.20€
Paga neto	466.80€

\*Shtesat tjera janë të gjitha kompenzimet që i bëhen të punësuarit e që përfshihen në pagën bruto siç është definuar në ligjin e Tatimit për të Ardhurat Personale.

\*\* Tatimi është kalkuluar si në rastin e punëdhënësit primar, pra me shkallë progresive. Në rastet kur punëdhënësi është sekondar, shkalla e tatimit është direkte (10%).

### Shembull i pagës së paguar në natyrë

Një i punësuar i punishtes së verës 'X' është paguar në natyrë për muajin maj 2012 meqë punëdhënësi ka mungesë të parave të gatshme (kesh). Punëtori merr 80 litra verë. Vlera e mallit në treg për atë artikull të verës është 4 €/litër. Paga mujore e të punësuarit për atë muaj do të jetë  $80€ \times 4l = 320€$ . Kontributi i të punësuarit dhe punëdhënësit për atë muaj do të jetë 16€ për secilin apo 32€ gjithsejt.

### Shembull i librit për kontributet pensionale

Nr. rend.	Nr. Personal	Emri	Mbiemri	Paga Bruto	Kontributi i të punësuarit në FKPK	Kontributi i punëdhënësit në FKPK	Totali i kontributeve në FKPK	Paga neto para tatimit	Tatimi në pagë	Paga neto
A	B	C	D	E	F = E*(prej 5% deri 15%)	G = E*(prej 5% deri 15%)	H = F+G	L		M

Numri personal – është numri i cili lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, i cili gjendet në letërnjoftim, patentë shoferi dhe pasaportë të secilit posedues të këtij numri. Në mungesë të numrit personal mund të përdoret numri individual fiskal i të punësuarit, i lëshuar nga ATK.

Emri dhe Mbiemri – është informatë e dhënë nga Regjistri Civil i Kosovës, përmes letërnjoftimit, patent shoferit, apo pasaportës.

Pagat bruto – është shuma e të gjitha të ardhurave të ofruara nga punëdhënësi për të punësuarin, siç është definuar në ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe aktet nënligjore përkatëse.

Kontributi i të punësuarit në FKPK – janë Kontributet Pensionale të obligueshme (5% e pagës bruto) dhe vullnetare të cilat nuk mund të tejkalojnë 10% të Pagës Bruto (E) e që paguhen në FKPK.

Kontributi i punëdhënësit në FKPK – janë kontributet pensionale të obligueshme (5% e pagës bruto) dhe vullnetare të cilat nuk mund të tejkalojnë 10% të Pagës Bruto (E) e që paguhen në FKPK.

Paga neto para tatimit – është paga e mbetur pas zbritjes së Kontributeve Pensionale të të punësuarit.

Tatimi në pagë – është tatimi i aplikuar në pagën neto para tatimit, sipas rregullave përkatëse

Paga neto – është paga në dispozicion për të punësuarin.



## Shembull i fletëpagesës



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



### FLETËPAGESA

Lloji i tatimit:	PENSIONET	 MFAKP80008403805
Periudha Tatimore:	4 2013	
Numri Fiskal:	600588977	
Emri i Biznesit/Individit:	TEST CORP	
Data Deklarimit:	06/08/2013 08:37	Shuma për pagesë: 1,375.81
Vula/Nënshkrimi:	Numri i Llogarisë: 1000430110000214 Teksti: Data: / /	Shuma e pagesës:



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



### FLETËPAGESA

Lloji i tatimit:	PENSIONET	 MFAKP80008403805
Periudha Tatimore:	4 2013	
Numri Fiskal:	600588977	
Emri i Biznesit/Individit:	TEST CORP	
Data Deklarimit:	06/08/2013 08:37	Shuma për pagesë: 1,375.81
Vula/Nënshkrimi:	Numri i Llogarisë: 1000430110000214 Teksti: Data: / /	Shuma e pagesës:

**ÇERTIFIKATA E KONTRIBUTEVE DHE TATIMIT TË MBAJTUR NË BURIM DHE TË PAGUAR NGA PUNËDHËNËSI**

**ÇERTIFIKATË E KONTRIBUTIT PENSIONAL DHE MBAJTJES NË BURIM TË TATIMIT NË PAGA**

*Informatat e punëdhënësit*

[1] Emri punëdhënësit: \_\_\_\_\_

[2] Numri fiskal i punëdhënësit:

[3] Adresa e punëdhënësit: \_\_\_\_\_

[4] Emri i pronarit/Menaxherit: \_\_\_\_\_

[5] Telefoni: \_\_\_\_\_

[6] E-mail: \_\_\_\_\_

*Kjo Çertifikatë e Kontributeve Pensionale dhe Mbjajtjes në Burim të Tatimit në të Ardhura Personale i lëshohet të punësuarit në vijim:*

*Informatat e të punësuarit*

[7] Emri i të Punësuarit: \_\_\_\_\_

[8] Numri Individual i të Punësuarit:

[9] Adresa e të Punësuarit: \_\_\_\_\_

[10] Telefoni: \_\_\_\_\_

[11] E-mail: \_\_\_\_\_

**Unë deklaroj se të dhënat e paraqitura mëposhtë janë të vërteta:**

Periudha tatimore [12]	Të ardhurat bruto [13]	Kontributi pensional i punëdhënësit [14]	Kontributi pensional i të Punësuarit [15]	Tatimi i Mbjatur në Burim [16]

Emri, Nënkroni dhe Vula e Punëdhënësit/Personit të Autorizuar

Data